

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.D., për shkak të veprës penale Grabitja ne tentative nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Peje të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Peje DKR.P.nr.36/2018 të datës 26.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **09. Janar. 2019**, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Peje, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Peje DKR.P.nr.36/2018 të datës 26.09.2018, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës themelore në Peje DKR.P.nr 36/2018 të datës 26.09.2018 ,e në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së i akuzuari B.D. në mungesë të provave është liruar nga akuza për shkak të veprës penale, Grabitja ne tentative nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë çështje penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Peje, për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Peje ta Anuloje dhe çështjen te ja kthej Gjykatës se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Gjithashtu përgjigjen ne ankese ka parashtruar mbrojtësja e te akuzuarit B.D. av.S.A. nga Peja duke propozuar qe ankesa e Prokurorisë Themelore ne Peje te refuzohet si e pabazuar ndërsa Aktgjykimi i ankimuar i Gjykates se shkalles se pare te vertetohet.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Peje , me shkresën e vet PPA.I.nr.532/18 të datës 27.11.2018 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Peje ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1.të KPPRK-së shqyrtoi shkresat e lendës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Peje dhe gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore ne Peje aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 nënpar.1. 12 e lidhur me nenin 370 par.7 te KPRK-se per faktin se Gjykata e shkalles se pare nuk e ka vlersuar ne menyre te veqant saktësinë e provave kundërthënëse dhe veqanerisht deklaraten e dëshmitarit V.Z., i cili nuk ka mundur saktësisht te deklarohet se kur ka ardhur nga Gjermani ne Kosove respektivisht ne Peje duke qene ne mëdyshje se a ka qene fundi i muajit Janar apo fillimi i muajit Shkurt te vitit 2018 dhe se Gjykata nuk eshte dashur qe tia fale besimin nje dëshmie te tille e te cilën i akuzuari e ka shfrytëzuar si alibi kinse ditën per te cilën eshte akuzuar se e ka kryer grabitjen te ket qene duke punuar te dëshmitari V.. per qka gjykata edhe e ka liruar nga akuza.

Sipas Prokurorisë Themelore ne Peje dispozitivi i aktgjykimit te atakuar është kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyet e aktgjykimit, në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare. Arsyet janë të paqarta dhe kundërthënëse në masë të konsiderueshme lidhur me faktet vendimtare, ashtu që kundërthëniet qëndrojnë në mes të arsyetimit të aktgjykimit dhe dispozitivit e te cilat aktgjykimin e atakuar e bëjnë të paqëndrueshëm dhe paraqesin bazë të mjaftueshme që ky aktgjykim të anulohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore te Prokurorisë Themelore ne Peje lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërthënie goftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetim janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në harmoni me nenin 370 të KPPRK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të pa provuara. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të tyre ka nxjerre konkludimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjithashtu, nuk ekzistojnë as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesën e Prokurorisë Themelore në Peje theksohet se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, kur për të akuzuarin B.D. ka gjetur se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale nga arsyeja se i pandehuri me asnjë nga deshmitaret e mbrojtjes e as provave të tjera nuk ka arritur ta vërtetojë alibinë për ditën kritike- date 01.02.2018, se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjendja faktike e vërtetuar nga ana Gjykata e shkallës së parë nuk vëhet në dyshim, ngase nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e sidomos gjatë dëgjimit të dëshmitarit V.Z. është vërtetuar se i akuzuari ka punuar tek ai në shtëpi diku kah fundi i Janarit apo fillimi i Shkurtit si punëtor krahu dy dite rresht dhe se ka qene data 28.01.2018 ngase ate dite ka ardhur në pushime nga Gjermania dhe pas tri dite ka dale në treg dhe i ka marrë 2 punetore që ta rregullojnë një kanalizim pra sipas tij kjo është data 01.02.2018 ngase me date 03.02.2018 ka pasur për tu kthyer në Gjermani. Kjo është vërtetuar edhe në bazë të deklaratës së dëshmitarit S.A. i cili ka punuar is punëtor krahu se bashku me të akuzuarin në shtëpinë e dëshmitarit V.Z. dhe ate dy dite rresht nga ora 08:00 deri në ora 17:00. Gjithashtu edhe dëshmitari S.I. në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se nuk është i sigurt në identifikimin e tani të akuzuarit dhe se për të personi që ka kryer aktin ka qene me i zi dhe se nuk mundet të deklarohet 100%, duke shtuar se sikur të ishte i sigurt që tani i pandehuri është kryesi i veprës penale pa pike dyshimi do të kisha thënë se “ju jeni ai që e keni kryer veperen penale”.

Pra gjykata e shkallës së parë të kjo gjendje e vërtetuar faktike të akuzuarin B.D. e ka liruar nga akuza në mungesë të provave e të cilën gjendje faktike e aprovon edhe Gjykata e Apelit e sidomos edhe nga arsyeja se edhe dëshmitari-hetuesi N.A. ka deklaruar se procedurën për identifikimin e personit të dyshimte nuk e kanë bërë krejtësisht në bazë të ligjit dhe nuk i kanë përfillur dispozitat ligjore duke mos përpiluar procesverbal gjatë ballafaqimit të dëmtuarit S.I. me të akuzuarin B.D.. Nga kjo del se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Peje lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk janë të bazuara ngase Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të vërtetojë se i akuzuari B.D. me date 01.02.2018 rreth orës 15:10 të ketë kryer veprën penale Grabitja në tentative nga neni 329 par 3 lidhur me nenin 28 të KPRK-se për të cilën ka qene i akuzuar.

Pra, nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin B.D., në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së e ka liruar nga akuza në mungesë të provave për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Peje lidhur me shkeljen e ligjit penal në favor të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.563/18, më 09.01.2019

Procesmbajtës
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Fillim Skoro
